



Data: 11.02.2020

Ref.: 147/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 79-të, të mbajtur më 16 dhe 17.01.2020, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit “Rezonanca” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2020 – 30 shtator 2023:
 - Farmaci Komunitare, BSc, 180 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik, dhe
 - Fizioterapi, BSc, 180 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik

- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji Rezonanca ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Rezonanca, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit. Vizita është realizuar me 24.10.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik dhe Delia Gologan.

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 16 dhe 17.01.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Rezonanca dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin e programit Farmaci Komunitare, BSc, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se ky program përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë shtatë (7) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se programi në fjalë i plotëson plotësisht dy (2) (Studentët; Infrastruktura dhe resurset) ndërsa plotëson substancialisht pesë (5) të tjera (Misioni, objektivat dhe administrimi; Menaxhimi i cilësisë; Stafi Akademik; Përmbajtja e procesit arsimor; Hulumtimi).

Sa i përket programit të studimit Fizioterapi, BSc, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit konstaton se ky program përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë shtatë (7) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se programi në fjalë i plotëson plotësisht tre (3) (Misioni, objektivat dhe administrimi; Stafi akademik; Studentët), ndërsa plotëson substancialisht katër (4) të tjera (Menaxhimi i cilësisë; Përmbajtja e procesit arsimor; Hulumtimi; Infrastruktura dhe resurset).

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Rezonanca
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë